

**Njoftim për përqendrim me të cilin Everlens SE, Gjermani do të fitojë kontroll mbi  
Everlens Muskat L.L.C., Sulltanati i Omanit  
(lënda nr. 08-20/2026)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 16.01.2026, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Everlens SE, me seli në adresën Shtadtbahstrasee 1, 86153 Augsburg, Gjermani, do të fitojë kontroll mbi Everlens Muskat L.L.C., me seli në adresën Ndërtesa nr. 258/258A, parcela nr. 55, Rusayl Industrial Estate, Muskat, Sulltanati i Omanit, përmes shitblerjes së pjesës

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:**

Everlens SE është një kompani inxhinierike gjermane e specializuar në sisteme shtytëse, dekarbonizim dhe zgjidhje për efikasitet për industrinë detare, sektorin energjetik dhe aplikime industriale. Everlens SE është shoqëri e varur indirekte e Volkswagen Aktiengesellschaft, e cila është shoqëri mëmë e Grupit Volkswagen.

Grupi Volkswagen është aktiv në nivel global në zhvillimin, prodhimin, marketingun dhe shitjen e automjeteve të pasagjerëve, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve, autobusëve turistikë, shasive për autobusë dhe motorëve dizel, si dhe motoçikletave, përfshirë edhe pjesët rezervë dhe aksesorët. Grupi Volkswagen është gjithashtu aktiv në shpërndarjen e automjeteve.

Grupi Volkswagen përfshin markat e automjeteve: Volkswagen, Volkswagen Commercial Vehicles, Porsche, Audi, Škoda, Bentley, Lamborghini, SEAT, Cupra, MAN, Scania dhe Ducati. Përveç kësaj, Volkswagen ka themeluar nën-markën MOIA, një ofrues shërbimesh teknologjike që fokusohet në një model të bazuar në platformë për ofrimin e mobilitetit autonom si shërbim (*mobility as a service – MaaS*).

Grupi Volkswagen është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të varura si në vijim:

- Porsche Leasing SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bul. Bosnja dhe Hercegovina nr. 3, Shkup;
- Porsche Broker SHA Shkup, me seli të regjistruar në Bul. Bosnja dhe Hercegovina nr. 3, Shkup;
- Scania Macedonia SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. 34 nr. 7, Ilinden, Shkup; dhe
- Porsche Macedonia SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bul. Bosnja dhe Hercegovina nr. 4, Shkup.

Veprimtaritë kryesore të këtyre shoqërive në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë tregtia me automjete motorike dhe lizingu financiar.

Everlens Muskat L.L.C. është një shoqëri e themeluar si investim i përbashkët dhe në pronësi të Everlens dhe grupit OPES/OHI. Everlens Muskat L.L.C. operon në Oman si shoqëri lokale e lidhur me Everlens dhe shërben si qendër rajonale e Everlens për menaxhimin e projekteve, shitjen dhe mbështetjen teknike, si dhe funksionon si qendër koordinimi për projektet e Everlens në shërbimet detare dhe prodhimin e energjisë. Everlens Muskat L.L.C. ofron gjithashtu shërbime pas shitjes, siç janë inxhinieria, mbështetja në terren dhe zgjidhjet për mirëmbajtjen e sistemeve shtytëse detare dhe impianteve për prodhimin e energjisë. Gjithashtu, Everlens Muskat L.L.C. kryen furnizim me komponentë rezervë industriale (p.sh. kushineta, boshte). Everlens Oman ndodhet në Muskat, Oman dhe ka operacione në të gjithë rajonin e Lindjes së Mesme.

Everlens Muskat L.L.C. nuk është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka realizuar asnjë të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë vitit 2024.

Për nevojat e vlerësimit të përqendrimit konkret, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu relevant i produkteve të përkufizohet si tregu për ofrimin e shërbimeve pas shitjes (p.sh. riparime, shërbime mirëmbajtjeje dhe pjesë rezervë) për turbo-makineri në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.*

*Komisioni i fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime lidhur me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup, ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

23.01.2026

Shkup